VENDIM
Nr.1487, datë 19.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA INSPEKTORATI NDËRTIMOR URBANISTIK KOMBËTAR, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar të përfundojë, deri në datën 25 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për tenderin me objekt "Blerje karburanti, gazoil, benzoil dhe karburant për ngrohje", të kryera nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar, në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha